



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 20  
Prishtinë, më 29.9.2021, në orën 12:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-10-

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Hykmete Bajrami, Arta Bajraliu, Mirlinda Sadiku, Eman Rrahmani, Enver Haliti, Yllza Hoti, Albana Bytyçi dhe Bekim Arifi.

**Munguan:** Fadil Nura, Adem Hoxha dhe Hajdar Beqa.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Antigona Ibraj dhe Mehmet Simnica.

**Të ftuar:** Ministri i MBPZHR, z. Faton Peci me stafin e tij.

**Pjesëmarrësit tjerë:** Çerkin Morina dhe Violeta Smajlaj nga ZKA dhe Evetar Zeqiri nga OSBE.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.9.2021;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2020, i ftuar ministri i MBPZHR, z. Faton Peci;
4. Rishqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2021;
5. Të ndryshme.

**Mbledhjen e kryesoi Hykmete Bajrami, kryetare e komisionit, e cila pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.**

### 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetarja** e hodhi në votim rendin e ditës, i cili u miratua pa ndryshime.

### 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 22.9.2021

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.9.2021, u miratuan me vërejtjet e deputetes znj. Mirlinda Sadiku.*

### 3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2020

**Kryetarja**, tha se për sot kemi vendosur shqyrtimin e raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2020, i ftuar për të arsyetuar raportin, është ministri i MBPZHR, me stafin e tij. Raportuese për të prezantuar këtë raport është deputetja Mirlinda Sadiku.

Raporti ka opinion të kualifikuar, si dhe një pjesë e të gjeturave janë të përsëritura nga viti paraprak. Me këtë fjalën e kaloi te Mirlinda Sadiku.

**Mirlinda Sadiku**, tha se është opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore për vitin 2020 për MBPZHR-në. Sipas auditorit të jashtëm, raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2019 për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka rezultuar me 12 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një plan veprimi, ku paraqitet mënyra sesi do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2020, 7 (shtatë) rekomandime janë zbatuar dhe 5 (pesë) rekomandime nuk ka filluar zbatimin ende. Parregullsi në regjistrimin dhe raportimin e pasurive. Pasuria kapitale (me vlerë mbi 1,000€) nuk prezanton vlerën e saktë të pasurive. Auditimi ka nxjerrë në pah se në 8 (tetë) raste, pasuria kapitale mbi 1,000€ ishte e mbivlerësuar për 371,496€, ndërsa ishte nënvlerësuar për 2 (dy) pagesa në vlerë 153,590€. Mangësi në procedimin e pagesave nga 13 mostra të testuara, në 4 (katër) prej tyre në vlerë prej 318,732€, kemi identifikuar se ministria, në fillim kishte pranuar faturën, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër-blerja. Mangësi në hartimin dhe miratimin e programit për pagesa direkte. Programi për pagesa direkte në bujqësi duhet t'i ketë të përcaktuara qartë afatet kohore për përgatitjen dhe miratimin e tij, si dhe të ketë të përcaktuara kriteret e mbështetjes financiare në përputhje me ndarjet buxhetore të vitit. Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, ministria edhe këtë vit, programin për pagesa direkte e kishte miratuar në korrik të 2020. Ky fakt ka shkaktuar vonesë në procesin e subvencionimit, duke filluar nga thirrja për aplikim, kontrollet në terren e deri te finalizimi i pagesës. Njëkohësisht, si rezultat i mospërcaktimit të kriteve të sakta në program, mbështetja financiare për fermerë përmes pagesave direkte, tejkalon buxhetin e miratuar vjetor. Shpaloje jo e drejtë e obligimeve të papaguara në PVF, shpaloje e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2020 nuk ishin pasqyruar drejt në PVF. Në 4 (katër) raste në vlerë prej 67,211€, obligimet e papaguara ishin mbivlerësuar, ndërsa në 2 (dy) raste në vlerë 143,706€, nuk ishin prezantuar në PVF. Po ashtu, theksoi se sipas raportit të auditimit, del se 12 prona të Institutit Bujqësor janë të uzurpuara nga uzurpatorët. **Mangësi në procedimin e pagesave**, nga 13 mostra të testuara, në 4 (katër) prej tyre në vlerë prej 318,732€, ZKA ka identifikuar se ministria, në fillim kishte pranuar faturën, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër-blerja. **Vonesa në pagesën e obligimeve**, nga lista e obligimeve të shpalosura në PVF, kemi testuar 13 mostra dhe nga testimi ka rezultuar se faturat në vlerë të përbashkët 147,446€, nuk ishin paguar brenda afatit të paraparë ligjor. Vonesat

në pagesa janë duke filluar nga 12 deri 204 ditë. Ndërsa, në 20 raste të ekzaminimit të pagesave për subvencionet e dhëna përmes Programit për zhvillimin e bujqësisë (grantet), në vlerë totale 916,431€, janë vërejtur se pagesat kishin tejkaluar afatet e përcaktuara për pagesë. Vonesat në rastet e ekzaminuara ishin nga 4 deri 194 ditë.

**Mangësi në hartimin dhe miratimin e programit për pagesa direkte**, programi për pagesa direkte në bujqësi duhet t'i ketë të përcaktuara qartë afatet kohore për përgatitjen dhe miratimin e tij, si dhe t'i ketë të përcaktuara kriteret e mbështetjes financiare në përputhje me ndarjet buxhetore të vitit. Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, ministria edhe këtë vit programin për pagesa direkte e kishte miratuar në korrik të vitit 2020. Ky fakt ka shkaktuar vonesë në procesin e subvencionimit, duke filluar nga thirrja për aplikim, kontrollet në terren e deri te finalizimi i pagesës. Njëkohësisht, si rezultat i mospërcaktimit të kriterëve të sakta në program, mbështetja financiare për fermerë përmes pagesave direkte, tejkalon buxhetin e miratuar vjetor. **Mangësi të identifikuar në subvencione.** Nga testimet e auditorit është vërejtur se në 6 (gjashtë) pagesa me vlerë 61,541€, ministria kishte subvencionuar përfituesit e pagesave direkte, edhe pse përfituesit në aplikacionet e tyre kishin ofruar fletat poseduese nga kadastra për sipërfaqe tokash, që nuk ishin në pronësi të tyre, por vetëm me mbiemër të njëjtë dhe nuk kishin ofruar ndonjë dokument si dëshmi të afërsisë familjare apo kontratë për marrjen me qira të pronës. Sipas shpjegimeve të menaxhmentit. Kjo ka ndodhur si rezultat i problemeve pronësore në nivel të përgjithshëm të vendit. **Vlerësim i aplikacionit jo në përputhje me UA për masat dhe kriteret e përkrahjes për Zhvillimin Rural.** Ne kemi identifikuar se në një rast, edhe pse përfituesi kishte një projekt tjetër të mëhershëm të financuar nga ministria, të cilin nuk e kishte realizuar sipas kushteve të kontratës dhe për të ishte në procedura gjyqësore, ministria kishte nënshkruar marrëveshje të re për financim, duke lidhur kontratë në vlerë 399,000€. Prej kësaj kontrate, AZHB do të mbështesë financiarisht subjektin në vlerë 199,500€ apo 50% të shumës maksimale të investimit të pranueshëm për "Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore". **Ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore.** Gjatë testeve në 2 (dy) raste kemi vërejtur që qiramarrësit e tokave bujqësore nuk ushtronin veprimtari përkatëse sipas ligjit, ku në vend të shfrytëzimit për tokë bujqësore kishin shfrytëzuar për qëllime ndërtimi të përkohshme, si depo për material ndërtimor dhe për tregtim të karburanteve. Po ashtu, nuk ishte aplikuar çmimi në përputhje me çmimet e tregut sipas zonave ku operojnë qiramarrësit. Për më tepër, shfrytëzuesit e pronave nuk kishin kryer obligimet sipas kontratës, për vlerën 20,000€. **Hyrja në obligime për pagesat direkte jo në përputhje me buxhetin.** Ministria kishte për zgjedhur fermerët, të cilët janë vlerësuar si përfitues të rregullt sipas programit vjetor për pagesat direkte (subvencionet), për vitin 2020 në vlerë 35,474,240€. Vlen të theksohet se ministria nuk përcakton kufizime të aplikuesve për përfitimin e subvencioneve dhe rrjedhimisht shuma e mjeteve të miratuara prej 24,000,000€ nuk mbulon realizimin e pagesave për të gjithë përfituesit e lartcekur. Me qëllim të mbulimit të pagesave për të gjithë përfituesit, pas kërkesës së ministrit të Bujqësisë, Qeveria në mbledhjen e datës 28.9.2020, me vendim nr. 03/33, miratoi dyfishimin e buxhetit për programin për pagesa direkte (subvencione), për secilën kulturë/masë të paraparë në programin e pagesave direkte për vitin 2020, duke krahasuar me vlerat e vitit 2019.

Mirëpo, edhe ky vendim nuk mbulon realizimin e pagesave për të gjithë përfituesit e pagesave direkte. Kjo, meqenëse edhe shpërndarja e subvencioneve për vitin 2020, duke krahasuar me vlerat e vitit 2019, kap totalin prej 30,842,294€, prej të cilave 11,925,954€ ishin paguar në vitin 2020 dhe 11,999,993€ do të paguhen në vitin 2021, e që rrjedhimisht pjesa e mbetur prej 6,916,347€ ka hyrë në obligime pa mbulesë buxhetore. Mungesa e realizimit të planit vjetor të punës në AZHB - Sipas planit vjetor të punës për vitin 2020, NJAB kishte planifikuar të kryejë 7 (shtatë) auditime. Megjithatë, gjatë vitit 2020 kishte përfunduar vetëm dy (2) prej tyre. Arsyet për ngecje në realizimin e planit vjetor 2020 janë mungesa e stafit auditues dhe punës me staf esencial gjatë periudhës së pandemisë.

**Ministri MBPZHR**, prezantoi para deputetëve përpjekjet që është duke bërë ministria për adresimin e të gjitha të gjeturave të auditorit të dhëna në raport. Përkundër faktit se një pjesë e rekomandimeve të dhëna kërkojnë kohë për implementim më gjatë se një vit. Po ashtu, njoftoi deputetët se ka filluar me shprehje të interesit për aplikim të bujqve për pagesa direkte. Përveç kësaj, ministri tha se për të gjithë ata që nuk zbatojnë rekomandimet e dhëna do të merren masa ndëshkimore. Po mundohemi për të bërë kritere të sakta për fermerë të cilët mendojnë të përfitojnë përmes formave të ligjshme.

**Çerkin Morina**, tha se Zyra Kombëtare e Auditimit ka pasur telashe në realizimin e këtij auditim për shkak se një pjesë e stafit të MBPZHR ishin nën hetime dhe se disa lëndë ishin element i hetuesisë. Përkundër kësaj të gjitha shkeljet e mundshme në këtë ministri nuk kemi mundur ti saktësojmë me këtë auditim, ti vërtetojmë dhe ti prezantojmë në këtë raport. Po ashtu, theksoi se është mirë që MBPZHR ka përgatitur planin e veprimit për të adresuar këto rekomandime. Po ashtu theksoi se dy opinione radhazi jo të mira për një institucion e vështirësojnë qasjen në institucione financiare ndërkombëtare.

**Kryetarja**, tha se është e vërtetë se me të njëjtën parcelë kanë përfituar me shumë se një përfitues, me një angazhime shumë të thjeshtë të zyrtarëve brenda MBPZHR, me një Excel është dashur të vërehet kjo parregullsi. Po ashtu, ka raste kur personat që kanë privatizuar parcela bujqësore nuk i punojnë ato toka po në të njëjtën kohë nuk i pengojnë edhe bujqit lokalë të i mbjellin ato toka, mirëpo për këtë nuk ju bëjnë kontrata për shfrytëzim të këtyre tokave. Si mendoni që mund t'ju ndihmoni këtyre bujqve që në fakt kanë punuar tokën, mirëpo nuk janë pronarë legjitim të tyre? Po ashtu, një pjesë e fermerëve bagëtinë e tyre gjatë verës e dërgojnë në vendet tjera në bjeshkë dhe nuk po mund të përfitojnë, ndërsa në disa raste ka përfituar dikush tjetër që jeton në banesë private dhe nuk ka fare bagëti. Po ashtu, vonesat në shpalljen e interesit për aplikim, do të paraqesin probleme në vërtetimin e sipërfaqeve të mbjella me kultura bujqësore, sepse një pjesë e tyre tani vetëm se janë vjelë. Po ashtu, një pjesë e bujqve nuk e dorëzojnë grurin në mullinj dhe tani po ju pamundësohet përfitimi për subvencione.

**Mirlinda Sadiku**, tha se a ekziston mundësia që për inspektimin e pronave dhe kulturave të mbjelluar të përdoret droni si mjet më i lehtë i kontrollit. Po ashtu, theksoi se në fshatin Debellde një fshatë në kufirin me Maqedoninë e Veriore, bujqve nuk po ju lejohet të dalin për t'i punuar tokat andej kufirit, për shkak se me demarkimin e kufirit tokat kanë mbetur në pjesën matanë kufirit. Zakonisht, në këtë trevë kultivohen papatet, të cilat janë kualitative. Andaj, kërkoj nga ministri i MBPZHR-së, të bisedojë me ministrin e MPJD znj. Gërvalla apo me ministrin e

Ministrisë së Bujqësisë të Maqedonisë së Veriut, për t'ua mundësuar që të punohen këto toka, në sipërfaqe prej 25 hektarëve. Po ashtu, një fermere femër që ka 300 dele dhe 20 bika për majmëri, mirëpo sipas kriterëve të MBPZHR-së nuk përfiton, për arsye se grurin nuk e ka dorëzuar në mullinj, ndërsa ka mbi 20 tonë grurë në hambarë. Si mendoni për t'i adresuar çështjet e ngjashme si kjo?

**Kryetarja** pyeti se sipas raportit të auditimit, është thënë në një rast se një fermer, edhe pse ishte duke u hetuar për abuzim me aplikacione, ai në të njëjtën kohë ishte edhe përfitues i grantit nga MBPZHR, si ka mundur të ndodhë kjo?

**Ministri i MBPZHR**, u përgjigj në pyetjet e parashtruara dhe premtoi se këto çështje do mundohet t'i adresojë.

**Eman Rrahmani**, pyeti: a ju është bërë e padrejtë bujqve që ju është kërkuar që vetëm për pjesën e grurit të dorëzuar në mullinj do të kompensohen nga 2 centë për kilogram gruri, të deponuar në mullinj, kur dihet se një pjesë e bujqve nuk kanë dorëzuar grurin në mullinj? Në rastin konkret mendoj se janë dëmtuar një pjesë e konsideruar e bujqve. Po ashtu, aplikimi për subvencionim përmes fletave poseduese të parcelave. Një pjesë e bujqve nuk do të aplikojnë vetëm për pjesën e 50% të përfitimit. Sipas z. Rrahmanit, të drejtën e përfitimit nga subvencionet e MBPZHR e kanë të gjithë bujqit të drejtën e njëjtë, sikur ata që kanë dorëzuar grurin në mullinj e sikur ata bujq që grurin e kanë mbajtur në hambarët e tyre privat. Po ashtu, pyeti: përveç ndryshimit të kriterëve nga MBPZHR, cilat janë ndryshimet tjera në menaxhim të vetë ministrisë?

**Ministri i MBPZHR**, u përgjigj në pyetjet e parashtruara, mirëpo insistoi se kriteret e dhëna tani nga Ministria e Bujqësisë janë të dizajnuara, që të mos ketë keqpërdorim të parasë publike. Ministri tha se këtu do të ketë vetëm drejtësi.

**Mirlinda Sadiku**, tha se do të ishte mirë, për shkak të opinionit publik, raporti të adresohet për në seancë plenare.

**Kryetarja** theksoi se për shkak se nuk kemi rekomandime të propozuara nga deputetët, raporti nuk mund të adresohet për në seancë plenare.

Komisioni nuk pati përfundim për këtë pikë.

#### **4. Rishqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2021**

Kjo pikë e rendit të ditës mbeti të trajtohet në mbledhjen e radhës së komisionit.

## 5. Të ndryshme

U propozua që mbledhja e radhës së Komisionit të mbahet të martën nga ora 10.00, për të provuar prapë të ftohet MPJD. Nuk pati diskutim tjetër për këtë pikë të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.  
E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetare e komisionit,

---

Hykmete Bajrami